

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Diana Sina dhe me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit G. P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, në Gjakovë, PP.nr.71/15, të dt.14.09.2015, në shqyrtimin publik gjyqësor të mbajtur me datën **30.11.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, të dëmtuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **G. P., i biri** i Xh., dhe i ëmës N., e gjinisë M., i lindur me datën ... në Gjakovë, ka të kryer fakultetin ekonomik, i martuar-atë i 4 fëmijëve, me profesion tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

### **Është fajtor**

**Sepse:** Me datën 22.01.2015 rreth orës 15:20 minuta, në Gjakovë, rr."F. A." derisa i dëmtuari shkon, në pompën e derivateve "S.", ku pronar është i akuzuari, që të e pastroj (laj) automjetin e tij, e nuk i mundësohet e kështu i inatosur i dëmtuari me tonë të lartë shanë e ofendon e më pas vazhdon e të akuzuarit i thotë " ma kajshit at non nëse vij këtu e marr derivate" nga i akuzuari sulmohet fizikisht e me grushte e godit tri herë në kokë, ku nga goditjet e të dëmtuarit R. Xh. B. nga Gjakova rr. "S." pn. i shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 28.04.2014 të Dr. M. G.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17, 41, 85, 86 par 1, 2 dhe 5 dhe nenit 188 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

### **VËRJETJE GJYQËSORE**

I dëmtuari R. B. nga Gjakova, Rr."S.", për të realizuar kërkesën e vet pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **50,00.-Euro**, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm, në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.71/2015, të dt. 14.09.2015, kundër të akuzuarit G. P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Fillimisht Prokurori i shtetit ka ngritur Aktakuzë PP.nr.71/15 të dt.14.09.2015 duke propozuar që ndaj të akuzuarit G. P. ti nxjerrë urdhër ndëshkimor me të cilin të njëjtit ti shqiptohet një dënim me gjobë, Gjykata ka aprovuar kërkesën e Prokurorit dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me gjobë në shumë prej 300 Euro, si dhe ka obliguar në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, për ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej 20 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 €, me aktgjykimin P.nr.603/15 të datës 12.05.2016, në afatin ligjor i akuzuari ka parashtuar kundërshtim kundër Aktgjykimit - urdhër ndëshkimor të lartë cekur, prandaj Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ndaj të akuzuarit G. P., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë truporë nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari G. P. në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.10.2016 në prezencë të mbrojtësit të tij avokatit T. B. sipas autorizimit, lidhur me fajësinë ka deklaruar se nuk e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, prandaj gjykata ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me procedurën e provave, ka dëgjuar dëshmitarët B. P., B. P., A. Rr., dhe seancën gjyqësore e ka shtyre me qëllim që të mirrët edhe deklarata e dëshmitarit R. A. i propozuar nga mbrojtësi i të akuzuarit avokati T. B.

I akuzuari G. P. në shqyrtimin gjyqësor të datës 30.11.2016 deklaroi se në këtë shqyrtim gjyqësor nuk ka angazhuar mbrojtës por do të mbrohet vet personalisht, ndërsa lidhur me fajësinë deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem dhe atë sipas vullnetit të lirë dhe pa imponim nga jashtë, duke ditur më parë për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, për të cilën jam penduar pa masë.

I dëmtuari R. B. nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit G. P., shton se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkoj kompensimin e dëmit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se meqenëse i akuzuari bënë pranimin e fajësisë, i cili pranim shihet se është bërë sipas vullnetit të lirë dhe pa imponime, dhe i njëjti pranim ka mbështetje nga provat në shkresat e lëndës propozoi që të bëhet pranimi i fajësisë të akuzuarit.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari G. P. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, dhe është i bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së, shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj në fjalën përfundimtare deklaroi se, me pranimin e fajësisë si dhe provat tjera mbështetëse materiale që gjenden në shkresat e lëndës, është vërtetuar se i akuzuari me datë, kohë dhe vend sipas aktakuzës PP.nr.71/15 të dt.14.09.2015, ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, prandaj gjykatës i propozoi që i njëjti të shpallet fajtor, por me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë, mos dënuesmerin e tij të më parme, faktin se vepra penale është kryer edhe nën provokim këtu të dëmtuarit, pajtueshmërinë e tyre në mesë veti të shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësor, pendimin e

tij, e nga këto të njëjtit ti shqiptoi një dënim që do të ketë efektin që në të ardhmen mos të përsërisë veprën e njëjtë, pra ti shqiptohet një vërejtje gjyqësore.

I dëmtuari R. B. në fjalën e vetë përfundimtare deklaroi, se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensimin e dëmit, ka qenë një mosmarrëveshje në afekt, vërtetë që edhe unë në atë moment jam ngutë me veprimet e mija, për të cilat edhe unë jam penduar, por menjëherë pas rastit jemi pajtuar në mes veti, kemi kërkuar njërit tjetrit falje dhe prej atij momenti nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mes veti, prandaj unë si palë e dëmtuar i propozoi gjykatës që ti njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të butë.

I akuzuari G. P. në fjalën e tij përfundimtare sërish bëri pranimin e fajësisë, deklaroi se sërish e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem, pendohem për veprën e kryer, por ditën kritike për veprimet e mija është e vërtetë siç tha edhe vetë i dëmtuari më ka nxitë ti ndërmarra ato veprime, por menjëherë pas rastit jemi pajtuar në mes veti, kemi kërkuar falje njërit tjetrit, dhe tani nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mes veti.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 73 të KPRK-ës, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, si rrethanë lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është mbajtës i vetëm i familjes, sjelljet e kryesit në të kaluarën se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata të akuzuarit t'i shqiptoj vërejtje gjyqësore, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë komfor nenit 450 par.1 dhe 2, nën par. 2.6, lidhur me nenin 453 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr.603/15 dt.30.11.2016**

**Sekretarja Juridike**

**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja**

**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15** ditësh, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.